Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/407
Datë: 20.08.2021

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për verifikimin e standardit të profesionit nr. 28/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 20.08.2021 nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet** Standardi i Profesionit sipas rekomandimit të ekipit të ekspertëve si Standard Kombëtar i Profesionit me kohëzgjatje 5 vjeçare, me këtë emërtim dhe kod:
   1.1 Mekanikët dhe riparuesit e automjeteve, me kodin 7231 dhe me nivelin V të kualifikimit sipas KKK.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Bazuar në kërkesën e Këshillit për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe për të Rritur, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (KAAPRr/MASHT) për verifikimin e standardit të profesionit. KD i AKK, në mbledhjen e mbajtur më 20.08.2021 shqyrtoj raportin e ekipit të ekspertëve për verifikim të standardit të profesionit dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve gjatë realizimit të takimeve dhe vizitave me palët e interesit, si dhe në rekomandimet përfundimtare, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë, sipas nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit kompetent, në afat prej 30 ditësh nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ, sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi u dërgohet:

1. KAAPRr.-së;
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar i KD-së AKK